

FJALA E DEPUTETIT SAIMIR HASALLA

E ENJTE 21 KORRIK 2022

E nderuar kryesuese e seancës plenare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot në seancën plenare diskutojmë rezolutën për KQZ-në për vitin 2021. Ndaj më lejoni që në krye të herës ta përgëzoj këtë institucion për punën e mirë të bërë gjatë vitit 2021, duke marrë parasysh se ishte vit elektorale dhe duke qenë se ishte hera e parë që performonte me formatin dhe strukturën e re të ndryshuar me ligjin e ri për Kodin Zgjedhor. Raporti vjetor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sot u paraqit në Kuvend nga ana e Komisionerit Shtetëror, por në punën e tij ka edhe dy komisione të tjera.

Në vitin 2021 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e nisi punën e riformuar tërësisht dhe i ndarë në 3 komisione: në Komisionin Shtetëror, i cili është organ monokratik, që ushtron kompetenca ekzekutive, drejton administratën e KQZ-së dhe përfaqëson KQZ-në në marrëdhënie ndaj të tretëve; në Komisionin Rregullator, i cili është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet, që del qartë në raport se ka pasur një volum të madh pune për sa i përket rregullimit të procesit zgjedhor, si dhe në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, që ka ushtruar funksionin e shqyrtimit të ankimeve administrative dhe vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor.

Këtë herë kemi edhe një risi tjetër për sa i përket nënkomisionit, i cili kryesisht është përgjegjës për përcaktimin e zbatueshmërisë dhe drejtimin e punës për identifikimin elektronik të votuesve. Një proces, i cili duhet pranuar se ka qenë një hap cilësor dhe kjo për meritë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të gjitha organeve të tjera që mundësuan këtë proces. Identifikimi elektronik i votuesve dhe votimi elektronik ka qenë një garanci e shtuar në procesin zgjedhor. Kjo gjë është konstatuar edhe nga vëzhguesit ndërkombëtarë dhe nga ata kombëtarë.

Në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, është bërë një punë për t'u vlerësuar nga komisioneri, pasi ka pasur një sërë procedurash rekrutimi.

Në lidhje me aksesin e publikut në veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mund të themi se ka pasur një përparim cilësor. Kjo ka ardhur si arsye e përdorimit të shumë instrumenteve, për shembull: ndërtimi i faqes së re zyrtare online, me një strukturë interaktive, në raport me informacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm për zgjedhësit, subjektet politike dhe palët e interesuara, ku të gjithë kanë pasur mundësi të marrin informacion për sa i përket vendimmarrjes së komisioneve të ndryshme, por edhe të rezultateve zgjedhore në kohë reale për çdo subjekt zgjedhor apo kandidat të ndarë në çdo qark apo bashki. Rritja e transparencës së këtij institucioni ka ardhur edhe si pasojë e përdorimit në mënyrë shumë efikase të të gjitha formave të komunikimit që ka përdorur qoftë komisioneri, qoftë edhe komisionet e tjera, gjë që ka rritur cilësinë e informimit.

Gjithashtu, është përdorur edhe një portal ku duhej të raportoheshin të gjitha veprimtaritë, aktivitetet që kryenin institucionet shtetërore për sa u përket datës, orës dhe vendit të aktivitetit për të përmbushur detyrimin e tyre që u ngarkon Kodi i ri Zgjedhor. Në lidhje me opinionet e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, vlen për t'u përmendur opinionin e misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve, OSBE/ODIHR-it, i cili thotë: "Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare ishin në përgjithësi të organizuara mirë nga administrata zgjedhore", pra KQZ-ja e sapoformuar me të 3 degët e saj mori përgjegjësi të zgjeruara dhe i përmbushi ato. Për sa i përket kontrollit administrativ, vihet re një trajtim me efektivitet i një numri të konsiderueshëm ankimesh administrative, me një proces shqyrtimi administrativ të shpejtë dhe transparent. Kjo tregon që formati i ri i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka funksionuar më së miri.

Këqyrja paszgjedhore, që e përmendi edhe komisioneri gjatë raportimit, tregoi edhe njëherë mirorganizimin e procesit zgjedhor. Në mënyrë rastësore u përzgjedhën 519 qendra votimi, të cilat përfaqësojnë 10% të qendrave të votimit për çdo KZAZ, një kampion i mjaftueshëm për të përcaktuar rregullsinë apo parregullsinë e procesit të numërimit. Është verifikuar administrimi i procesit zgjedhor, ku 86% e verifikimit është në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore; është verifikuar administrimi i bazës materiale, ku 93% është në përputhje; janë verifikuar

procesverbalet, ku 82% e tyre janë tërësisht të administruara në përputhje me kërkesat ligjore; është verifikuar saktësia e numërimit të votave dhe rezultoni se vetëm në 1% të qendrave të votimit rezultoi një diferencë nga 10 në 30 vota, pra tërësisht e pakonsiderueshme dhe e papërfillshme për ndryshimin e rezultatit të përgjithshëm.

Për sa u përket problematikave që vihen re, të cilat edhe komisioneri i përmendi gjatë fjalës së tij dhe i ka paraqitur të gjitha në raportin vjetor, në Komisionin e Ligjeve miratuar edhe projektrezolutën për vitin 2022, ku i kërkohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve plotësimi i disa detyrave dhe jam besimplotë për realizimin e tyre. Në mbyllje të fjalës sime, i uroj suksese komisionerit në realizimin e këtyre detyrave! Ju faleminderit të gjithëve!